

VENDIM
Nr. 868, datë 14.12.2016

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, TË PASURISË SË PALUAJTSHME ME EMËRTIM “GJYKATA E APELIT SHKODËR”, ME QËLLIM PAJISJEN E SUBJEKTIT “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË” ME NDËRTESE PËR DEGËN VENDORE TË PARTISË SOCIALISTE, QARKU SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, shkronja “b”, e 22/1, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, dhe të neneve 8, pika 3, 13 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Punëve të Brendshme, të pasurisë së paluajtshme, me emërtim “Gjykata e Apelit Shkodër”, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratuar me vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit”, të ndryshuar, me qëllim pajisjen e subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë” me ndërtesë për Degën Vendore të Partisë Socialiste, Qarku Shkodër.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministri i Punëve të Brendshme të lidhë kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë, në përputhje me shkronjën “b”, të nenit 22, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, për periudhën deri sa partia politike plotëson kushtet e parashikuara në këtë nen.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

I. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror Bashkia/komuna: Shkodër Fusha e përdorimit të pronës: zyra										
Nr. rend.	A			B			C			
	Zona kadastr. & indeksi i hartës	Nr. punërisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale: sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera Shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
9	8594 Sh-M-7 Shtet Sh-M-9 Vol.9 Fq.82 Shtet	4/236 4/235	Ndërtesë Parkim	Gjykata e Apelit Shkodër L. “Vojo Kushi” përballë Poliklinikës Qendrore	728 (m ²)	638 (m ²)	Zyra	Gjykata e Apelit Shkodër	Gjykata e Apelit Shkodër	Godina ka tre kate Gjykata ndodhet në tre katet. Në mes të katit të parë dhe të dytë, ndodhet prokuroria, me sip. 35.5 m ²